



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

TERMA REFERENCE

MIKPRITJE DHE HISTORI NË DIVANIN E PASHAIT

TEPELENË 2024

HYRJE

Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Bashkia Tepelenë, Shqipëri.

Qëllimi i dokumentit

Qëllim i këtij dokumenti është:

- Detajimi i specifikimeve tekniko – funksionale për nevojat e ndryshme të projektit për zbatimin e projektit të sistemit të parkimit dhe rrugës së shërbimit;
- Shpërndarja dhe prezantimi i kërkesave tek kompanitë e interesuara për zbatimin e këtij sistemi.

OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA (PJESA E PARKINGUT)

Objektivi i Përgjithshëm

Objektivat kryesorë të projektit (të cilat janë kërkesat kryesore të zgjidhjes së aplikuar) përfshijnë:

- Vendosjen e një sistemi automatik për të administruar hyrje/daljet e mjeteve në ambientet e parkimit pranë Kalasë së Tepelenës.
- Vjelja e të ardhurave që vijnë nga parkimi i mjeteve dhe menaxhimi i fluksit të automjeteve që vizitojnë Tepelenën dhe hapësirën brenda Kalasë Tepelenë;
- Ofrimi i opsioneve dhe shërbimeve të ndryshme ndaj qytetareve;
- Monitorimi i ambientit të parkimit;
- Raportimi në kohe reale mbi vijueshmërinë e punës dhe të ardhurat e gjeneruara nga ambientet e parkimit;

Qëllimi

Qëllimi(et) i këtij investimi është:

- Implementimi i nje sistemi të automatizuar parkimi për menaxhimin e ambientit të parkimit;
- Implementimin e software të menaxhimit të të ardhurave dhe sistemit të parkimit;
- Vjelja e të ardhurave nga sistemi i parkimit;
- Menaxhimi i fluksit të automjeteve që aksesojnë ambientet e Kalasë Tepelenë.

Komponentet e Projektit

Bashkia Tepelenë kërkon që sistemi automatik i parkimit të jete i përberë nga komponentet:

Software – levrimi, instalimi dhe integrimi i nje aplikimi (sistemit të informacionit), i cili duhet të përmbushë të gjitha kërkesat e paraqitura në këtë dokument.

Pajisje hardware – levrimin dhe instalimin e pajisjeve hardware të cilat do të plotësojnë kushtet dhe kërkesat e paraqitura në këtë dokument.

Shërbime të zbatimit të sistemit – Zbatimi i sistemit në ambientet dhe infrastrukturën e ambienteve të parkimit në menaxhim nga Bashkia Tepelenë. Kjo do të përfshijë testimin dhe demonstrimin e mirë përdorimit të sistemit, si dhe asistencën e stafit të Bashkisë Tepelenë në procesin e testimit si dhe të pranimit funksional.

Trajnimi – Pjesë e projektit është trajnimi i personelit të Bashkisë Tepelenë në drejtim të aspekteve teknike dhe operacionale të përdorimit të sistemit.

Suport fillestar (në vend) – për një periudhe operimi fillestare të moduleve të veçantë të sistemit, kërkohet gjithashtu suporti në vend si dhe kontrolli i veprimtarisë fillestare të Bashkisë Tepelenë në përdorimin e sistemit. Suporti fillestar do të realizohet në përputhje me përcaktimet në këtë dokument.

Suport dhe mbështetje në vend – pjese e projektit është suporti dhe mbështetja teknike dhe funksionale e operimit të sistemit. Suporti do të realizohen në distance ose nëpërmjet paraqitjes në vend të personelit teknik të ofertuesit (nëpërmjet një qendre asistence). Suporti do të realizohet në përputhje me përcaktimet në kete dokument.

Rezultatet që duhet të arrihen nga Kontraktori

Rezultat kryesore që duhet të mbërrihen nëpërmjet projektit janë:

- Implementimi i një sistemi automatik parkimi përfshirë rrugën e shërbimit.

- Implementimi i një Sistemi Software e mbështetur me konfigurimet përkatëse dhe integruar me sisteme të tjera për të kryer tërësinë e funksionaliteteve të kërkuara.
- Krijimin e raporteve statistikore dhe menaxhimi i të ardhurave të sjella nga ambienti i parkimit nëpërmjet këtij softwar-i.
- Trajnimi – Pjesë e projektit është trajnimi i personelit të Bashkisë Tepelenë në drejtim të aspekteve teknike dhe operacionale të përdorimit të sistemit.
- Suport fillestar (ne vend) – për një periudhë operimi fillestare të moduleve të veçantë të sistemit, kërkohet gjithashtu suporti në vend si dhe kontrolli i veprimtarisë fillestare të Bashkisë Tepelenë në përdorimin e sistemit. Suporti fillestar do të realizohet në përputhje me përcaktimet në këtë dokument.

QËLLIMI I PUNËS

Të Përgjithshme

Implementimi i sistemit të sigurve për mbledhjen e të ardhurave nga parkimi në 2 ambientet e parkimit.

Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Në afërsi të Kalasë Tepelenë (Sipërfaqe parkimi + Infrastruktura funksionale/lidhëse).

Grupet e synuara

Nga zbatimi i sistemit, synohet përmirësimi i efikasitetit të ambienteve të parkimit dhe rritja e opsioneve dhe shërbimeve ofruar ndaj qytetarëve/banorëve dhe turistëve/vizitorëve.

Siguria e sistemit

Elementet e sigurisë së zbatuara duhet të jene të një standardi të lartë dhe të kenë një aplikim të gjere. Për këtë, baza e të dhënave dhe aplikimi kërkohet të plotësojë një sërë kushtesh sipas përcaktimeve në termat teknike.

Detyrat specifike

Modelimi i sistemit

Në këtë fazë specialistet e ofruesit të shërbimit do të punojnë bashkë me stafin e Bashkisë Tepelenë për të përcaktuar qartë të gjitha veprimet që do të kryhen për të realizuar këtë projekt dhe të gjitha përmirësimet që do të kryhen për administrimin e sistemit të parkimit.

Ne fund të kësaj faze do të përpilohet dhe firmoset nga të dyja palët një protokoll që përcakton në termat e mësipërm modelin e Sistemit që do të zbatohet dhe që do të shërbejë si udhëzues për zbatimin e hapave të mëtejshëm të projektit.

Ndërtimi i infrastrukturës

Gjatë kësaj faze do të lëvrohen dhe instalohen pajisjet hardware bashkë me software-t e nevojshëm për funksionimin, mbrojtjen dhe sigurinë e sistemit, në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në këtë dokument.

Në fund të procesit do të përpilohet dhe firmoset akti i dorëzimit të infrastrukturës së sistemit i cili duhet të përmbajë specifikimet për të gjithë komponentet si dhe vlerësime apo sugjerime të mundshme nga të dyja palët që lidhen me shkallen e integritetit të komponenteve dhe vlerësimin për zbatimin e hapave të mëtejshëm.

Zbatimi dhe testimi i sistemit

Në këtë fazë do të bëhet konfigurimi i nevojshëm për të gjithë komponentet që do të jenë pjesë e këtij sistemi. Këto procese duhet të kryhen me prezencën e personelit të Bashkisë Tepelenë.

Në përfundim të kësaj faze, do të hartohet dhe firmoset akti i pranimit funksional të sistemit i cili duhet të përmbajë përshkrimin e komponenteve e procedurave si dhe vlerësime apo sugjerime të mundshme nga të dyja palët që lidhen me funksionimin e sistemit dhe shkallen e transferimit të njohurive.

Mbështetja Teknike dhe Dorëzimi i Sistemit

Ofertuesi kërkohet, në përputhje me kërkesat në këtë dokument, të realizojë mbështetjen fillestare në vend përgjatë fillimit të përdorimit të sistemit. Për këtë, kërkohet që personeli teknik i ofertuesit të jete prezent në vend (pranë ambientit të parkimit) përgjatë një periudhe fillestare 2 ditore të operimit. Pas periudhës së mbështetjes në vend, ofertuesi duhet të ofrojë gjithashtu shërbimin e suportit dhe mirëmbajtjes sipas përcaktimeve në terma (me poshtë).

Përgjatë periudhës së suportit në operacional si dhe atij të suportit në vend, Ofertuesi duhet të planifikojnë dokumentimin e kërkesave për suport, zgjidhjen si dhe përshkrimin e zgjidhjes.

Për çdo kërkesë, ofertuesi duhet minimalisht të regjistrojë numrin serial të kërkesës, kërkuesin e shërbimit, datën e kërimit, problematiken, kategorizim i përgjithshëm i kërkesës, gjendjen e kërkesës si dhe datën dhe përshkrimin e zgjidhjes. Regjistrimi i kërkesave duhet të dërgohet në mënyrë të rregullt pranë Bashkisë Tepelenë.

Trajnimi i personelit për përdorimin dhe administrimin e sistemit

Trajnimet e realizuara në kuadrin e këtij projekti, në mënyrë të veçantë, duhet të përfshijnë module specifike për:

- Staf i parkimit – rreth përdorimit të përditshëm të sistemit
- Personelin teknik i Bashkia Tepelenë rreth teknologjisë së programeve dhe pajisjeve si dhe procedurave standarde të operimit dhe të mirëmbajtjes.

Trajnimet duhet të organizohen nga personel trajnues me eksperience dhe kërkohet të shoqërohen me materiale trajnimi të përgatitura për Bashkia Tepelenë, si dhe me pune praktike direkt në sistem. Materialet si dhe trajnimi kërkohet të zhvillohet në një ambient të dedikuar për këtë qëllim si dhe të jete në gjuhën shqipe.

Dokumentacioni

Dokumentacioni i sistemit duhet të hartohet në përputhje me zhvillimet dhe me instalimet specifike në Bashkia Tepelenë dhe të jete në gjuhën shqipe.

Ofruesi duhet t'i levroje Bashkisë Tepelenë minimalisht materialet e mëposhtme:

- Literaturën standarde të produkteve – duke përfshirë komponentët specifike, të cilët trajtojnë të gjitha kërkesat sipas specifikimeve në këto kërkesa.
- Dokumentacionin teknik si dhe skemën e instalimit dhe konfigurimit të sistemit.
- Dokumentacion për suportin, operimin dhe mirëmbajtjen.
- Manualet e përdoruesve

Dokumentacioni standard i produktit duhet të jete në anglisht ose shqip.

Të gjitha dokumentet kryesore të realizuara enkas për Bashkia Tepelenë duhet të jepen si në trajtë elektronike ashtu dhe në letër.

LOGJISTIKA DHE KOHA

Vendndodhja:

Hapësirë parkimi pranë Kalasë Tepelenë, Qytet Tepelenë.

Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave:

Data e fillimit të projekti do të jete data nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik apo bashkimin e operatorëve fitues të këtij projekti dhe periudha e implementimit të sistemit do të jetë 60 ditë.

RAPORTIMI

Kërkesat e Raportimin

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në origjinal:

- *Raporti Fillestar* prej maksimumi 10 faqesh duhet të prodhohet pas 2 javësh nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaje p.sh. gjetjet fillestare, progresin në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritur ose të hasur përveç programit të punës. Kontraktuesi duhet të vazhdojë punën derisa Autoriteti Kontraktues të dërgojë komente mbi raportin fillestar
- *Drafti i raportit përfundimtar* i faqeve maksimale 10 (teksti kryesor, duke përjashtuar anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se 10 (dhjete) dite përpara përfundimit të periudhës së zbatimit të sistemit.
- *Raporti final* me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 3 (tre) ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse

Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet grupit të punës së Projektit të identifikuar në kontratë. Grupi i punës së Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

GARANCIA

Garancia minimale e kërkuar për pajisjet dhe programet është 1 vit. Procedurat përgjatë kësaj periudhe duhet të jenë sikurse përshkruar me poshtë.

MIRËMBAJTJA

Termet e mirëmbajtjes

Mirëmbajtja që duhet të ofrohet gjatë periudhës së garancisë duhet të sigurojë marrjen e të paktën shërbimeve të mëposhtme:

- Garanci për të gjitha pajisjet;
- Gatishmërinë e suportit 5 (pesë) dite në jave, gjatë orarit zyrtar të punës.

Mbajtja e një qendre asistence

Pas pranimit të plote të sistemit nga Bashkia Tepelenë, ofruesi duhet të përcaktojë një pikë kontakti për të gjitha tipet e problemeve. Pika e kontaktit duhet të sigurojë prezencën e stafit të kualifikuar për t'u përgjigjur në telefon problemeve, tentoje zgjidhjen e tyre nëpërmjet aksesit remote të sistemeve dhe nëse kjo është e pamundur, duhet të paraqitet në vend.

Mirëmbajtja e programit

Mirëmbajtja e programit (bazës së të dhënave dhe komponenteve të tjerë të lidhur) si dhe e përditësimeve, përgjatë periudhës së garancisë, do të realizohet falas, nëpërmjet suportit direkt apo indirekt. Pas kësaj periudhe të njëjtat terma të garancisë do të shtrihen në shërbimin e suportit.

Për këtë, minimalisht, ofertuesi duhet të paraqesë suportin e prodhuesit për të njëjtën periudhë. Ky suport i prodhuesit duhet të përmbajë përditësimet falas për produktet e reja si dhe suportin teknik të prodhuesit në rastin e problemeve.

Mirëmbajtja e pajisjeve

Garancia e pajisjeve dhe përditësimet e tyre me versionin e fundit të prodhuesit, përgjatë periudhës së garancisë, do të realizohet falas. Ndërkohë që dedektimi dhe suporti i pajisjeve do të realizohen në vend (ne ambientin e parkimit) ndërsa zëvendësimi i pajisjeve të dëmtuara duhet të realizohet sipas specifikimeve. Pas kësaj periudhe të garancisë të njëjtat terma do të shtrihen në shërbimin e suportit.

Për këtë, minimalisht, ofertuesi duhet të paraqesë suportin dhe garancinë e prodhuesit e prodhuesit për të njëjtën periudhë. Ky suport i prodhuesit duhet të përmbajë përditësimet falas për produktet e reja si dhe suportin teknik të prodhuesit në rastin e problemeve.

AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Fazat e projektit/investimit 12 muaj.

TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Aplikimi/sistemi i kërkuar duhet të realizohet dhe të jete plotësisht funksional në një kohë relativisht të shkurtër. Ai duhet të ofrojë siguri, kontroll si dhe automatizim maksimal të procedurave të mirëmbajtjes.

PERSHKRIM I KERKESAVE FUNKSIONALE të SISTEMIT të PARKING

1. Përshkrim i përgjithshëm i zgjidhjes

Sistemi i Parking do të administrojë hyrje/daljet në parking dhe do të llogarisë e arkëtojë të ardhurat sipas tarifave të konfiguruar në sistem.

Sistemi i parkingut do të ketë një korsi hyrje, një krosi dalje si dhe një kioskë për arkëtimin e pagesave dhe menaxhimin e hyrje/daljeve për parkimin Kalaja Tepelenë.

Korsia e hyrjes duhet të ketë një kolonë të sistemit të parkingut e cila do të shërbejë për lëshimin e biletave të parking. në distance rreth 2-4 metra nga kolona, pengesa e aksesit të makinave duhet të kryhet me një barriere automjetesh.

Kjo kolonë duhet të jetë e ndërtuar në mënyrë që të mundësojë marrjen komode të biletës ose leximin e kartës nga shoferi pa dale nga automjeti. Lëshimi i biletës, duhet të regjistrojë në sistem dhe në biletë orën e saktë të hyrjes në parking dhe duhet të lëshohet vetëm nëse ka automjet në prani të kolonës. Kjo do të pengonte marrjen e biletës në mungesë të makinës apo keqpërdorimit të marrjes së biletës.


Kolona duhet të jete e pajisur me një monitor me ngjyra me madhësi minimum 7" i cili të instruktojë dhe njoftojë përdoruesit për procesin e aksesit në parking. P.sh. kur të afrohet në kolonën e hyrjes, përdoruesi të lexojë në ekran orën, informacion mbi marrjen e biletës etj. Gjithashtu në rast se ka ndonjë problem me procesin e aksesit, kolona duhet të shfaqë në ekran informacion mbi këtë problem.

Lëshimi i biletës duhet të behet nga një printer termik i instaluar brenda kolonës, duke printuar barcode i cili, do të lexohet në lexuesin barcode të instaluar në kolonën e daljes si dhe me lexuesin barcode të operatorit të parking gjatë procesit të arkëtimin.

Menjëherë pas tërheqjes së biletës nga kolona e aksesit në hyrje, barriera duhet të hapet menjëherë. Automjeti duhet të lejohet të kalojë traun brenda 5-8 sekondave. Pas kësaj kohe, ose nëse automjeti kalon traun, bileta quhet e pavlefshme, barriera duhet të mbyllet automatikisht, duke mos lejuar kalimin e automjeteve të tjera.

Barriera duhet të jete e pajisur me sensor magnetik (loop detector) të instaluar në toke, në mënyrë që të mos mbyllet gjatë kalimit të automjetit në korinë e hyrjes, si dhe të dedektojë kalimin e automjetit. Pas kalimit të automjetit, sensori do të "lajmërojë" barrierën që të mbyllet. Barriera e hyrjes duhet të ketë opsionin e montimit në trupin e saj një semafor i cili ka për detyrë të njoftojë përdoruesit për statusin e barrierës.

Aksesimi për punonjësit dhe automjetet e institucionit të Bashkisë Tepelenë do të kryhet nëpërmjet regjistrimit paraprakisht të targës së këtyre automjeteve dhe hyrje/dalje vetëm duke lexuar targën e automjetit në ambientet e Kalaja Tepelenë.



Bileta e marrë në kolonën e hyrjes, do të regjistrohet në sistem automatikisht. në momentin që automjeti dëshiron të dale nga parking, duhet të kalojë më parë për kryerjen e pagesës në makineri që pranon pagesat në mënyrë automatike ose nga arkëtari për të kryer pagesën.

Bileta e lëshuar nga kolona hyrëse, duhet të ketë të printuar një sistem Barcode i cili do të duhet të lexohet në lexuesin e sistemit të arkëtimit të lidhur me kompjuterin dhe software e parking. Barcode i gjeneruar nga sistemi duhet të përcaktojë në mënyrë unike biletën e cila pas leximit dhe përlllogaritjes së kohës, duhet të shfaqe shifrën që duhet të paguhet. Pasi kryhet pagesa, me të njëjtën biletë të hyrjes, automjeti duhet të drejtohet për nga korsia e daljes.


Korsia e daljes duhet të ketë një kolonë të sistemit të parkingut e cila do të shërbejë për leximin e biletave ose leximin e kartës të parking pasi të jete kryer pagesa. në distance rreth 2-4 metra nga kolona, pengesa e aksesit të makinave duhet të kryhet me një barriere automjetesh. Kjo kolonë duhet të jete e ndërtuar në mënyrë qe të mundësojë leximin komod të biletës nga shoferi pa dale nga automjeti. Leximi i biletës, duhet të regjistroje në sistem orën e sakte të daljes nge parking dhe bileta duhet të lexohet vetëm nëse ka automjet në prani të kolonës.

Kolona duhet të jete e pajisur me një monitor me ngjyra me madhësi minimumi 7" i cili të instruktoje dhe njoftoje përdoruesit për procesin e aksesit në parking. P.sh. kur të afrohet në kolonën e daljes, përdoruesi të lexoje në ekran orën, informacion mbi leximin e biletës etj. Gjithashtu në rast se ka ndonjë problem me procesin e aksesit, kolona duhet të shfaqe në ekran informacion mbi këtë problem.

Leximi i biletës me barcode të lëshuar nga kolona e hyrjes, do të lexohet në lexuesin barcode të instaluar në kolonën e daljes.

Menjëherë pas leximit se biletës nga kolona e aksesit në hyrje, barriera duhet të hapet menjëherë. Automjeti duhet të lejohet të kalojë traun brenda 5-8 sekondave. Pas kësaj kohe, ose nëse automjeti kalon traun, barriera duhet të mbyllet automatikisht, duke mos lejuar dalje të tjerë.

Barriera duhet të jetë e pajisur me sensor magnetik (loop detector) të instaluar në tokë, në mënyrë që të mos mbyllet gjatë kalimit të automjetit në korsinë e hyrjes, si dhe të dedektojë kalimin e automjetit. Pas kalimit të automjetit, sensori do të “lajmërojë” barrieren që të mbyllet.



*

Kolonat e hyrjes e të daljes duhet të komunikojnë në kohë reale nëpërmjet rrjetit IP me Sistemin Qendror të Parkimit. Me Sistem Qendror të Parkimit do të kuptojmë pajisjen kompjuterike qendrore në të cilën është instaluar software i menaxhimit të sistemit të parkimit. Kolonat duhet të mund të punojnë përkohësisht edhe në rast se Sistemi Qendror është i fikur apo nuk komunikon me to. P.sh. Nëse një makine ka hyrë në parking, ka kryer pagesën dhe do të dalë gjatë kohës që Sistemi Qendror nuk komunikon me kolonat, kolona dalëse do të mund ta lejojë leximin e biletës në dalje dhe daljen e makinës nga parking.

Në mënyrë të ngjashme, edhe kur kolona e hyrjes nuk komunikon me Sistemin Qendror, do të mund të lëshojë bileta. Kjo situatë duhet të lehtësojë punën për aksesin në parking për një interval të shkurtër kohe.

2. Software i sistemit të Parking

Sistemi i Parking do të duhet të administrohet nga nje sistem software i instaluar në një server qendror ose mbi një makine virtuale. Sistemi Software i Parking duhet të jete i ndërtuar mbi platformën Windows dhe të mund të shfrytëzojë shërbimet e Windows Active Directory. Kjo do të mundësonte rritjen e sigurisë së sistemit, fleksibilitet, sinkronizim dhe lehtësi në përdorim dhe mirëmbajtje.

Pajisjet fizike të sistemit të parking duhet të komunikojnë në kohe reale nëpërmjet rrjetit IP me Sistemin Qendror dhe software. Kolonat duhet të regjistrohen në Domain e ndërtuar nga Active Directory e Windows në mënyrë qe të sinkronizojne të dhënat si ora, përdoruesit e sistemit, të dhënat e databazës etj. Kjo duhet në mënyrë qe edhe në rast se do të ketë një shkëputje të komunikimit apo fikje të përkohshme të server, kolonat dhe aksesi të vazhdojnë me të dhënat offline që mbajnë vetë kolonat.

Software duhet të jete i ndërtuar në forme klient-server për të mundësuar ndarjen e shërbimeve dhe fleksibilitet. Licenca e sistemit duhet të jete e ripërtëritshme për të lejuar shtimin e mëvonshëm të funksioneve dhe pajisjeve të sistemit.

- Në sistemin software duhet të konfigurohen tarifat e parking në bazën e kohës së hyrjes
- Të ketë mundësi të konfigurimit të tarifave fleksibel në kohe dhe pagesave fikse (jo të varura në kohe)
- Të ketë mundësi të vendosjes se një intervali kohe tolerance pa pagese për lëvizjen brenda në parking.

Software duhet të monitoroje në kohe reale të gjitha pajisjet e sistemit: kolonat, lexuesit, barrierat, etj. në rast problematike, sistemi duhet të kete mundësinë të njoftoje operatorin mbi problemin. Sistemi duhet të mundësojë aksesin me fjalëkalim për përdorues të niveleve dhe të drejtave të ndryshme.

Administratori i sistemit duhet të ketë të drejtë ekskluzive mbi të gjitha funksionet e konfigurimet e sistemit. në sistem duhet të konfigurohet përdoruesi Operator i cili do të ketë funksionin e arkëtarit. Ky përdorues duhet të ketë të drejta vetëm mbi modulën e pagesave dhe jo mbi funksione të konfigurimit të sistemit.

Përdoruesi duhet të ketë mundësinë të shohë shumën e parave qe janë arkëtuar gjatë ditës si dhe ta zbrazë arken në momentin e mbylljes se turnit. Çdo përdorues duhet të ketë emrin dhe password e tij të aksesit në sistem.

Software duhet të kete mundësi të hapjes, mbylljes, lënies hapur apo mbyllur të barrierave manualisht dhe këto veprime të regjistrohen në log file e sistemit.

Software duhet të ketë një databazë Dbms të strukturuar dhe të ndërtuar për ruajtjen e të dhënave të formë fleksible. Sistemi duhet të kryeje backup të databazës në kompjuter.

Ndërfaqja e sistemit të pagesave duhet të jete e ndërtuar me ikona të cilat mund të përdoren lehtësisht nga një ekran i komandueshëm me prekje (touch screen).

KËRKESAT TEKNIKE

Ky seksion përmban kërkesat e detajuara për të gjithë komponentët e projektit. të gjitha kërkesat e mëposhtme duhet të jene subjekt i përgjigjeve të drejtpërdrejta të ofertuesve duke dhënë gjithashtu detaje të mënyrës se zgjidhjes se kërkesave në sistemin e propozuar. Përgjigje të organizuara jo në formë të tillë do të përbëjnë kusht shkualifikimi.

	Kërkesat nga autoriteti kontraktor	Përgjigje nga ofertuesi
1. Pajisje për lëshimin dhe matjen e kohës e parkimit, me ekran dhe aksesore		
Përshkrim i përgjithshëm	<p>Kolona e aksesit në hyrje të parking të mjeteve motorike do shërbeje për të kontrolluar aksesin e hyrjes në parking.</p> <p>Për automjetet të cilat kërkojnë të hyjnë në parking, kolona duhet të ketë mundësinë e lëshimit të biletës se parkimit nëpërmjet printerit termik të instaluar brenda kolonës. Sapo të tërhiqet bileta e parking nga kolona, duhet të mundësohet hapja menjëherë e barrierës se automjeteve.</p> <p>Kolona duhet të jete funksionale dhe të mundësojë ndërfaqesimin e elementeve të ndryshëm duke ofruar komunikimin dhe ushqimin e ndërfaqeve. Kolona duhet të ketë gjithashtu opsionet :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lexues RFID - Lexues Barcode 1D/2D - Lexues TAG <p>Kolona duhet të lëshojë biletën apo të lexoje kartën RFID vetëm nëse ka automjet pranë kolonës. për këtë duhet instaluar sensor/spire magnetike, në afërsi të kolonës, i cili aktivizon funksionet e kolonës dhe i jep mundësinë të merret bileta. në mungese të pranisë se makinës, kolona duhet të jetë në gjendje pritje (stand-by) duke ulur ndriçimin për të kursyer energji. Drejtuesi i automjetit, duhet të aktivizojë lëshimin e biletës me prekjen (touch, jo push) e një pulsanti i</p>	

	cili ndriçohet në prezencën e automjetit. Kjo do të mundësonte përdorimin intuitiv e të lehte të kolonës.	
Karakteristika fizike	<p>Kolona duhet të jete e ndërtuar për këtë qëllim me përmasa të përshtatshme në mënyrë që të mundësojë shoferin të lexojë biletën apo kartën e aksesit pa zbritur nga makina.</p> <p>Te jete e ndërtuar me material alumini, ose inox të pa ndryshkshem e të jete i lyer me boje në mënyrë që të durojë kushtet atmosferike, temperaturat e larta e të ulta, diellin, dhe lagështirën.</p> <p>Të ketë kapak të hapshëm në njërin krah për të asistuar pajisjet e instaluara në të dhe të mbyllet në mënyrë hermetike sipas standardit IP43.</p> <p>Te punoje në temperaturat nga $-20\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri $+40\text{ }^{\circ}\text{C}$.</p>	
CPU dhe ndërfaqet e komunikimit	<p>Kolona duhet të ketë një ndërfaqe elektronike inteligjente CPU e cila të shërbejë si menaxher dhe ndërfaqe e i pajisjeve që do të montohen në kollone. Nderfaqja elektronike duhet të jete e ndërtuar mbi bazen e një qarku logjik me CPU dhe që funksionon me një sistem operativ si Windows apo Linux.</p> <p>Ndërfaqja, duhet të ketë portë për kartë memorie SD, 2 porta USB dhe 1 Hdmi ku mund të lidhet monitor për konfigurimin dhe shfaqjen e informacioneve ndihmese për hyrjen me akses.</p> <p>Kolona duhet të ketë një ekran/display të paktën 7 inch me ngjyra, i cili do të shërbejë për të shfaqur informacione, ikona dhe mesazhe gjate procesit të aksesit në parking.</p> <p>Të ketë sensor të matjes se intensitetit të dritës në mënyrë që automatikisht të rrisë ndriçimin e ekranit në rast kohe me diell apo të ulë ndriçimin në rast kohe të vrenjtur apo natën në mënyrë që të optimizohet konsumi i energjisë.</p> <p>Kolona duhet të jete e ndërtuar me module qarqesh logjike në mënyrë që të ofrojë shtimin e opsioneve në rast nevojë.</p> <p>Ndërfaqet e hyrje-daljeve të kërkuara në kolonë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Porte rrjeti ethernet 10/100 Mbps 	

- 3 Porta Hub USB për lidhjen e moduleve me njëra tjetrën dhe me opsionet e ndryshme që mund të shtohen si printer, skaner biletash, barcode reader etj.
- Ndërfaqe MicroUSB
- Ndërfaqe display LVDS për të lidhur ekranin e kolonës
- Porte HDMI
- Ndërfaqe SD Card
- Ndërfaqe për të lidhur një kamera opsionale
- Ndërfaqe për të instaluar opsionin e touch screen.
- Altoparlant
- Ndërfaqe komunikimi me Barrierën në forme seriale RS-485Celes për komandim manual të barrierës.

Kolona, duhet të jete e pajisur me printer termal për printimin e biletave të parkimit. Printeri mund të përdorë letër në forme rruli ose fanfold:

- Rezolucion printimi 200 DPI
- Leter me gjeresi 50mm deri në 80mm
- Trashesi letre: 60 deri në 110 g/m²
- Printim > 250 mm/sec
- Rrul leter (diameter 180mm) ose fan-fold (5,000 bileta)
- Printon Barcode 1D/2D: CODABAR, CODE93, CODE128, CODE32, QRCODE, UPC-A, UPC-E, EAN13, EAN8, CODE39, ITF, PDF417, DATAMATRIX, AZTEC
- Prerje letre automatike.
- Ndërfaqe komunikimi USB

Skedat duhet të kenë drita sinjalizuese për të shfaqur gjendjen e komunikimit dhe në rast problemesh teknike të ndihmoje në evidentimin e problemeve.

Ndërfaqe dhe pajisje opsionale që mund të instalohen në kolonë në një moment të dytë:

	<ul style="list-style-type: none"> - Ndriçim sinjalizues që konturon kolonën për tu dalluar me qartë natën, ndriçim për panel informativ/reklamë, citofoni për komunikim me asistencën qendrore, etj. - Videokamera të drejtuar nga fytyra e shoferit. - Audio Citofon për komunikimin me piken e shitjes - Barcode Reader 1D/2D - Etj. 	
Ushqimi dhe karakteristika ambientale	<p>Tensioni i ushqimit të kolonës 100-240 V, Max 5A</p> <p>Ushqimi i pajisjeve në barriere të jete me tension të ulet 12/24 V DC.</p> <p>Temperatura e punës -20 °C deri në +40 °C, Lagështia 90%.</p> <p>Shkalla e mbrojtjes nga faktoret ambientale IP43.</p>	
Aksesore	<p>Kolonat duhet të jenë të qëndrueshme dhe duhet të montohen në terren duke betonuar më parë një element mbajtës i cili duhet të funksionojë si bazament i kolonës.</p> <p>Kolona duhet të ketë mundësi të montohet e çmontohet lehtësisht nga bazamenti.</p> <p>Për dedektimin e prezencës së automjetit dhe drejtimit të lëvizjes në korsitë, duhet të instalohen në toke të paktën 2 spira magnetike (loop) për çdo korsitë. Duhet të parashikohen të gjitha aksesoret për instalimin e këtyre loop.</p>	

	Kërkesat nga autoriteti kontraktor	Përgjigje nga ofertuesi
2. Pajisje për kontrollin e pageses së parkimit me display dhe aksesore		
Përshkrim i përgjithshëm	<p>Kolona e aksesit në dalje të parking të mjeteve motorike do shërbejë për të lexuar biletën e marrë në hyrje në parking pasi është bërë pagesa ose për leximin e kartës RFID. në këtë rast, nëse pagesa është kryer, drejtuesi i mjetit, afrohet pranë kolonës në dalje në të cilën lexon biletën dhe hap traun në dalje.</p> <p>Kolona duhet të jete funksionale dhe të mundësojë</p>	

	<p>ndërfaqesimin e elementeve të ndryshëm duke ofruar komunikimin dhe ushqimin e ndërfaqeve. Kolona duhet të ketë opsionet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lexues RFID - Lexues Barcode 1D/2D - Lexues TAG <p>Kolona duhet të lexojë biletën, kartën RFID vetëm nëse ka automjet pranë kolonës. Për këtë duhet instaluar sensor/spire magnetik në prani të kolonës, i cili aktivizon kolonën dhe i jep mundësinë të lexohet bileta. në mungesë të pranisë së makinës, kolona duhet të jete në gjendje pritje (stand by) duke ulur ndriçimin për të kursyer energji. Drejtuesi i automjetit, duhet të lexojë biletën në lexuesin barcode të instaluar në kolonë i cili ndriçohet me prezencën e automjetit.</p>	
Karakteristika fizike	<p>Kolona duhet të jetë e ndërtuar për këtë qëllim me përmasa të përshtatshme në mënyrë që të mundësojë shoferin të lexojë biletën apo kartën e aksesit pa zbritur nga makina.</p> <p>Te jete e ndërtuar me material alumini, ose inox të pa ndryshkshem e të jetë i lyer me boje në mënyrë që të durojë kushtet atmosferike, temperaturat e larta e të ulta, diellin, dhe lagështirën.</p> <p>Te ketë kapak të hapshëm në njerin krah për të asistuar pajisjet e instaluara në të dhe të mbyllet në mënyrë hermetike sipas standardit IP43.</p> <p>Te punoje në temperaturat nga $-20\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri $+40\text{ }^{\circ}\text{C}$.</p>	
CPU dhe ndërfaqet e komunikimit	<p>Kolona duhet të ketë një ndërfaqe elektronike inteligjente CPU e cila të shërbejë si menaxher dhe ndërfaqe e i pajisjeve që do të montohen në kolonë. Ndërfaqja elektronike duhet të jete e ndërtuar mbi bazën e një qarku logjik me CPU dhe që funksionon me një sistem operativ si Windows apo Linux.</p> <p>Ndërfaqja, duhet të ketë portë për karte memorie SD, 2 porta USB dhe 1 Hdmi ku mund të lidhet monitor për konfigurimin</p>	

dhe shfaqjen e informacioneve ndihmese për hyrjen me akses.

Kolona duhet të ketë një display të paktën 6.5 inch me ngjyra me rezolucion 480x640 pixel, i cili do të shërbejë për të shfaqur informacione, ikona dhe mesazhe gjate procesit të aksesit në parking.

Të ketë sensor të matjes se intensitetit të dritës në mënyrë që automatikisht të rrisë ndriçimin e ekranit në rast kohe me diell apo të ulë ndriçimin në rast kohe të vrenjtur apo natën në mënyrë që të optimizohet konsumi i energjisë.

Kolona duhet të jete e ndërtuar me module qarqesh logjike në mënyrë qe të ofrojë shtimin e opsioneve në rast nevoje.

Ndërfaqet e hyrje-daljeve të kërkuara në kolonë janë :

- Porte rrjeti ethernet 10/100 Mbps
- 3 Porta Hub USB për lidhjen e moduleve me njera tjetren dhe me opsionet e ndryshme qe mund të shtohen si printer, skaner biletash, barcode reader etj.
- Ndërfaqe MicroUSB
- Ndërfaqe display LVDS për të lidhur ekranin e kolonës
- Porte HDMI
- Ndërfaqe SD Card
- Ndërfaqe për të lidhur një kamera opsionale
- Ndërfaqe për të instaluar opsionin e touch screen.
- Altoparlant
- Ndërfaqe komunikimi me Barrieren në formë seriale RS-485 dhe komande
- Çelës për komandim manual të barrierës

Në kolonë duhet të jete instaluar lexuesi barcode i biletave: Duhet të lexojë formatin barcode 1D/2D të biletave të leshuara, si dhe të biletave apo kuponave të paraprintuar. Ky skaner barcode duhet të ketë mundësinë të leximit te kuponave barcode 2D në Smartphone.

	<p>Skedat duhet të kenë drita sinjalizuese për të shfaqur gjendjen e komunikimit dhe në rast problemesh teknike të ndihmojë në evidentimin e problemeve.</p> <p>Ndërfaqe dhe pajisje opsionale që mund të instalohen në kolonë në një moment të dyte:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndriçim sinjalizues që konturon kolonën për tu dalluar me qarte natën, ndriçim për panel informativ/reklamë, citofoni për komunikim me asistencën qendrore, etj. - Videokamera të drejtuar nga fytyra e shoferit. - Audio Citofon për komunikimin me piken e shitjes - Printer Fature jo Fiskale. - Etj. 	
Ushqimi dhe karakteristika ambientale	<p>Tensioni i ushqimit të kolonës 100-240 V, Max 5A</p> <p>Ushqimi i pajisjeve në barriere të jete me tension të ulët 12/24 V DC.</p> <p>Temperatura e punës -20 °C deri në +40 °C, Lagështia 90%.</p> <p>Shkalla e mbrojtjes nga faktorët ambiental IP43.</p>	
Aksesore	<p>Kolonat duhet të jenë të qëndrueshme dhe duhet të montohen në terren duke betonuar më parë një element mbajtës i cili duhet të funksionojë si bazament i kolonës. Kolona duhet të ketë mundësi të montohet e çmontohet lehtësisht nga bazamenti.</p> <p>Për dedektimin e prezencës së automjetit dhe drejtimit të lëvizjes në korsi, duhet të instalohen në toke të paktën 2 spira magnetike (loop) për çdo kolonë. Duhet të parashikohen të gjitha aksesoret për instalimin e këtyre loop.</p>	

3. Pajisje barriere për kontrollin e lëvizjes së mjeteve (të komandueshme nga sistemi i parkimit)		
Përshkrim i përgjithshëm	<p>Për të administruar aksesin e makinave, kërkohet të instalohen edhe barriera automjetesh.</p> <p>Barriera të jete prodhuar nga i njëjti prodhues i kolonave dhe sistemit të aksesit si dhe të ketë ndërfaqe komunikimi data me kolonën në mënyrë që sistemi software të komunikojë e menaxhojë barrierën.</p> <p>Kjo barriere duhet të ketë mundësinë për të instaluar në trupin e saj, në lartësinë e traut, një semafor LED, RGB i cili do të shërbejë për të njoftuar përdoruesit e parkimit të cilët kërkojnë të hyjnë në parking.</p>	
Karakteristika teknike e fizike	<p>Tensioni i punës: 100-240 V \pm10% / 50-60 Hz / rreth 500 W Temperatura e punës: -20 °C to 50 °C.</p> <p>Trupi i barrierës, të jete i ndërtuar me materiale të forta e të pandryshkshme. Të ketë mbrojtje ambientale me standard IP44.</p> <p>Barriera të ketë mundësi të hapet e mbyllet me shpejtësi dhe kjo shpejtësi të jete e konfigurueshme nga software i sistemit të parking.</p> <p>Barriera duhet të ketë opsionin e shtimit të një semafor të instaluar në trupin e barrierës, me led me 3 ngjyra RGB, e cila duke u ndriçuar me ngjyra të ndryshme dhe të konfigurueshme, informon drejtuesin e mjetit në mënyrë inteligjente mbi kalimin në barriere. Këto opsione të jene të personalizueshme nga software i sistemit të parking.</p> <p>Trau i barrierës të jetë i ndërtuar me material të lehte por durues i kushteve atmosferike si dhe në rast goditje me automjetin, të rrezohet në toke për të mos dëmtuar automjetin. Krahu i barrierës të ketë gjatësinë 3m.</p> <p>Krahu i barrierës të mund të komandohet nga një elektromotor</p>	

	<p>dhe të mos jete i ndërtuar me pajisje hidraulike të cilat kane nevoje për asistence. Të jete pajisje e qëndrueshme dhe koha e llogaritur ndërmjet mirëmbajtjeve (e deklaruar nga prodhuesi në katalog) të jetë rreth 2 milion cikle.</p> <p>Krahu i barrierës duhet të jetë me materiale të lehta e të forta në mënyrë qe të lehtësohej hapjen e krahut. Krahu i barrierës të ketë mundësi të vendosjes se ndriçimit të krahut për tu dalluar me qarte natën.</p> <p>Të ketë nje bord/ndërfaqeje inteligjente e cila të komunikojë në mënyrë seriale: RS485 me kolonën e hyrjes apo daljes duke njoftuar mbi statusin e korsisë.</p> <p>Të ketë të instaluar 1 dedektor magnetik automjetesh me 2 kanale i cili të lidhet me spirat magnetike të montuara në toke. Poshtë krahut të barrierës duhet instaluar nje spire e konfiguruar në nje nga kanalet e dedektorit, për të parandaluar mbylljen e barrierës në momentin qe kalon automjeti.</p> <p>Gjithashtu kjo do të njoftoje sistemin e parkimit mbi hyrje-daljet nga secila porte. në kanalin tjetër të dedektorit duhet të instalohet spira tjetër e prezencës në kolonë e cila njofton sistemin për prezencën e automjetit dhe aktivizon funksionet e kolonës.</p>	
Karakteristika funksionale	<p>Barriera të ketë logjike inteligjente me të cilën duke komunikuar me elementet e tjerë si kolona, loop detector, etj, të ketë mundësinë e konfigurimit nga software në rrjet, monitorimit të gjendjes se barrierës, update të software/firmware të barrierës, testim në distance, etj.</p> <p>Shpejtesia e hapjes se barrieres të jete e konfigurueshme nga software i sistemit të parking.</p> <p>Të ketë dedektor të dëmtimit apo mungeses se traut.</p> <p>Barriera duhet të komunikojë në kohe reale me software e</p>	

	sistemit të parking, duke treguar statusin e saj, si p.sh. Hapur, Mbyllur, offline, etj., si dhe të mund të merren informacione mbi problematiken e barrierës në kohe reale.	
Opsione shtese	<p>Barriera të ketë mundësi shtese të mëvonshme në rast nevojë te:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të ketë aftësi të mbaje krah të gjatë deri në 4,5m. - Të ketë mundësi opsionale të montimit në një moment të dytë të një krah të ndriçuar me drita RGB, të cilat ndizen me ngjyra të ndryshme sipas lëvizjes së krahut të barrierës. Ky opsion duhet të jetë i konfigurueshem nga software. - Ndriçim i konturuar me LED përreth barrierës për të dalluar me qartë barrierën natën. - Mundësi instalimi i një kamere në trupin e barrierës. - Mundësi instalimi të lexuesve TAG direkt në barriere. 	

Barriere automjetesh me krah 3m		
Përshkrim i përgjithshëm	<p>Për të administruar aksesin e makinave, kërkohet të instalohen edhe barriera automjetesh.</p> <p>Barriera të jete prodhuar nga i njëjti prodhues i kolonave dhe sistemit të aksesit si dhe të ketë ndërfaqe komunikimi data me kolonën në mënyrë që sistemi software të komunikojë e menaxhojë barrierën.</p>	
Karakteristika teknike e fizike	<p>Tensioni i punës: 100-240 V ±10% / 50-60 Hz / rreth 500 W</p> <p>Temperatura e punës: -20 °C to 50 °C</p> <p>Trupi i barrieres, të jetë i ndërtuar me materiale të forta e të pandryshkshme. Të ketë mbrojtje ambientale me standard IP44.</p> <p>Trau i barrierës të jete i ndërtuar me material të lehtë por durues i kushteve atmosferike si dhe në rast goditje me automjetin, të rrezohet në toke për të mos dëmtuar automjetin.</p> <p>Krahu i barrierës të ketë gjatësinë 3m.</p> <p>Barriera të ketë mundësi të hapet e mbyllet me shpejtësi dhe kjo shpejtësi të jete e konfigurueshme nga software i sistemit te</p>	

	<p>parking.</p> <p>Krahu i barrierës të mund të komandohet nga një elektromotor dhe të mos jete i ndërtuar me pajisje hidraulike të cilat kane nevoje për asistence. të jete pajisje e qëndrueshme dhe koha e llogaritur ndërmjet mirëmbajtjeve (e deklaruar nga prodhuesi në katalog) të jete rreth 2 milion cikle.</p> <p>Krahu i barrierës duhet të jetë me materiale të lehta e të forta në mënyrë që të lehtësojë hapjen e krahut. Krahu i barrierës të ketë mundësi të vendosjes se ndriçimit të krahut për tu dalluar me qartë natën.</p> <p>Të ketë një bord/ndërfaqeje inteligjente e cila të komunikojë në mënyrë seriale: RS485 me kolonën e hyrjes apo daljes duke njoftuar mbi statusin e korsisë.</p> <p>Të ketë të instaluar 1 dedektor magnetik automjetesh me 2 kanale i cili të lidhet me spirat magnetike të montuara në tokë. Poshtë krahut të barrierës duhet instaluar një spire e konfiguruar në një nga kanalet e dedektorit, për të parandaluar mbylljen e barrierës në momentin që kalon automjeti.</p> <p>Gjithashtu kjo do të njoftojë sistemin e parkimit mbi hyrje-daljet nga secila portë. në kanalin tjetër të dedektorit duhet të instalohet spira tjetër e prezencës në kolonë e cila njofton sistemin për prezencën e automjetit dhe aktivizon funksionet e kolonës.</p>	
<p>Karakteristika funksionale</p>	<p>Barriera të ketë logjike inteligjente me të cilën duke komunikuar me elementet e tjerë si kolona, loop detector, etj, të ketë mundësinë e konfigurimit nga software në rrjet, monitorimit të gjendjes se barrierës, update të software/firmware të barrierës, testim në distance, etj.</p> <p>Shpejtësia e hapjes se barrierës të jete e konfigurueshme nga software i sistemit të parking.</p> <p>Të ketë dedektor të dëmtimit apo mungesës së traut.</p>	

	Barriera duhet të komunikojë në kohe reale me software e sistemit të parking, duke treguar statusin e saj, si p.sh. Hapur, Mbyllur, offline, etj, si dhe të mund të merren informacione mbi problematiken e barrierës në kohe reale.	
Opsione shtese	<p>Barriera të ketë mundësi shtese të mëvonshme në rast nevojë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të ketë aftësi të mbajë krah të gjatë deri në 4,5m. - Barriera duhet të ketë mundësinë e instalimit të një semafor, në trupin e barrierës, me led me 3 ngjyra RGB, e cila duke u ndriçuar me ngjyra të ndryshme dhe të konfigurueshme, informon drejtuesin e mjetit në mënyrë inteligjente mbi kalimin në barriere. Këto opsione të jenë të personalizueshme nga software i sistemit të parking. - Të ketë mundësi opsionale të montimit në një moment të dytë të një krah të ndriçuar me drita RGB, të cilat ndizen me ngjyra të ndryshme sipas lëvizjes së krahut të barrierës. Ky opsion duhet të jetë i konfigurueshem nga software. - Ndriçim i konturuar me LED përreth barrierës për të dalluar me qartë barrierën natën. - Mundësi instalimi i një kamere në trupin e barrierës. - Mundësi instalimi të lexuesve TAG direkt në barriere. 	

4. Pajisje për leximin e biletave		
Përshkrim i përgjithshëm	Skeneri i leximit të biletave do të përdoret për të lexuar biletat me barcode të lëshuara nga sistemi. Pas leximit, skeneri barcode i dërgon software të menaxhimit të Parking numrin e biletës për të përcaktuar vlerën e pagesës.	
Skaner biletash	Skanimi të barkodeve me 1 linjë Shpejtesia e skanimit: 250 skanime në sekonde. Kendi i leximit, deri në 65 grade.	
Ndërfaqe	Pajisja të lidhet me kompjuterin e operatorit me portë USB.	
Kushtet e punës	Ushqimi të jetë 220V. Temperatura e punës nga 0 °C deri në +40 °C Standardi ambiental IP41	

5. Software qendror për menaxhimin e qendëruar të sistemit të parkimit	
Përshkrim i përgjithshëm	<p>Sistemi i administrimit të parking duhet të përbehet nga njejt hardware si dhe sistemin e menaxhimit software. Me programin për administrimin të parkimit, do të kuptohet tërësia e moduleve software të cilat shërbejnë për menaxhimin e sistemit të aksesit dhe parkimit.</p> <p>Ky software duhet të jetë i realizuar në të qendëruar dhe i ndërtuar me module software të cilat mund të instalohen në hardware të veçantë për të shpërndarë ngarkesën në rast nevojë.</p> <p>Të gjitha modulet e kërkua duhet të shoqërohen me licencat përkatëse. Modulet dhe zërat opsionale të jene të mundshme të shtohen me kërkesën e kontraktorit në rast nevojë.</p>
Karakteristika funksionale	<p>Duhet të këtë disa nga funksionet kryesore të Software të Sistemit parkimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Modulin e konfigurimit të sistemit - Modulin e konfigurimit të përdoruesve - Modulin e arkëtimit dhe prodhimit të lejeve të parking <p>Software qendror duhet të instalohet në sistem Windows Server, në mënyrë që të konfigurohet Active Directory e dedikuar për këtë software. Integrimi me AD, do të mundësojë sinkronizimin e të gjitha kolonave të hyrje daljes, pajisjeve dhe kompjuterëve në të njëjtën kohë, përforcimin e sigurisë dhe administrimin e komunikimit në rrjet në mënyrë të centralizuar.</p> <p>Kolonat duhet të kenë sistem operativ (Windows ose Linux) në mënyrë që të jene pjesë e këtij domain AD. Kjo do të duhet për funksionin e sinkronizimit të ores, përdoruesve, password dhe të drejtave në mënyrë të qendëruar.</p> <p>Software duhet të jete ndërtuar për të përmbushur nivelin e sigurisë të procedimit të kartave të kreditit sipas kriterëve ndërkombëtare PCI/PA-DSS.</p> <p>Sistemi i Parking duhet të funksionojë normalisht edhe në rast se për një interval kohe jo të gjate, Software ose server nuk mund të komunikojnë me pajisjet e parking (offline). Kjo do të thotë që software qendror duhet të replikojë të dhënat me pajisjet periferike duke bërë që këto të fundit të përdorin inteligjencën dhe të dhënat lokale në modalitet offline.</p>
Arkitektura e sistemit	<p>Sistemi software i menaxhimit të parking të makinave duhet të jetë i ndërtuar bazuar në arkitekturën klient-server. Software duhet të ketë ndërfaqet e</p>

	<p>konfigurimit të sistemit të cilat duhet të aksesohen vetëm nga përdoruesit administratore të cilat kanë të drejta ekskluzive mbi konfigurimet në sistem. Gjithashtu duhet të ketë edhe ndërfaqet klient të operatoreve të cilët duhet të kenë të drejta të kufizuara në konfigurimin e sistemit dhe të drejta sipas niveleve të përcaktuara në ndërfaqet e operimit, kontrollit dhe administrimit financiar të sistemit.</p> <p>Komunikimi në rrjet dhe ndërmjet moduleve të jete i enkriptuar.</p> <p>Të dhënat e sistemit duhet të ruhen në një databaze DBMS e cila të jetë fleksibel, dhe e sigurtë. Vetë databaza duhet të jetë e enkriptuar në mënyrë që të sigurojë kofidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave në sistem.</p>
<p>Moduli i konfigurimit dhe administrimit të sistemit</p>	<p>Ky modul software do të shërbejë për të konfiguruar të gjitha opsionet e sistemit të aksesit. Funkzionet kryesore të te modulit të konfigurimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të konfigurojë sistemin në tërësi, zonat e aksesit dhe ato të parkimit, të dhënat mbi monedhën e përdorur, zonën kohore, të dhëna mbi operatorin etj. - Të konfigurojë në sistem të gjitha nyejt hardware si Kolonat, lexuesit, Pajisjet PDA, Pajisjet e prodhimit të biletave dhe kartave si dhe të gjitha pajisjet e tjera ndihmese të sistemit të aksesit. - Të ketë funksionin e dedektimit automatik të pajisjeve të lidhura në sistem nëpërmjet skanimit të rrjetit Ip . - Të ketë funksionin e administrimit të artikujve të aksesit, biletave, kartave, Tag UHF etj. Çdo artikull mund të personalizohet sipas kërkesave të kontraktorit duke mundësuar shumëllojshmëri artikujsh dhe mënyrash aksesimi për persona të ndryshëm. - Regjistrimi i përdoruesve të sistemit të aksesit si dhe caktimi i personalizuar i aksesit afatgjate nëpërmjet kartave, tag UHF etj. - Vendosja e tarifave për çdo artikull dhe aplikimi i tarifave sipas politikave të përcaktuara nga Kontraktori në baze të intervaleve kohore, ditëve javore, festave etj. - Konfigurimi i kohës se aksesit afatgjate për përdoruesit me kontrate në mënyrë të personalizuar për çdo përdorues (Opsionale: nëse do të përdoren përdorues me kontrate paraprake dhe akses në parking me karte RFID, TAG, Akses Barcode etj.). - Të ketë mundësi e ruajtjes të të dhënave të rëndësishme për personat të cilët do të administrohen në sistemin e kontrollit të aksesit si: <ul style="list-style-type: none"> o Emri, Mbiemri, Kompania, ID, Adresa etj.

	<ul style="list-style-type: none"> - Konfigurimi dhe administrimi i stafit dhe përdoruesve të software. Çdo përdorues i software duhet të autentikohet në sistem duke vendosur emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin e tij. Çdo përdorues mund të personalizohet në nivelet e aksesit në software sipas nevojave dhe detyrës. - Te mund të aktivizohen licencat e sistemit. - Te mund të krijohet një axhendë për kryerjen e backup automatik dhe arkivimin e të dhënave - Te mund të konfigurohet numërimi i mjeteve.(Opsionale) - Te ketë një ndërfaqe të konfigurimit të Validimit të aksesit i cili ka qëllim krijimin e biletave apo kartave të personalizuara të cilat kanë si funksion dhënien e mundësisë të vlerësimit të një biletë sipas mundësive të mëposhtme : <ul style="list-style-type: none"> o Specifikimi i një intervali tarife parkimi apo qëndrimi minimale dhe maksimale o Intervali kohe për përdorimin e validimit o Lejimi apo jo i një pike validimi o Aplikimi i tarifave skonto me përqindje mbi një tarife të caktuar.etj <p>Ndërfaqja e Validimit do të mund të përdoret nga operatori për të mundësuar parking falas ose me vlere të zbritur për automjete të përzgjedhura sipas kërkesës së kontraktorit.</p>
Moduli i pagesave dhe i lëshimit të biletave	<p>Ky modul software ka si qëllim kryesor funksionimin si nyje për leximin e biletave, shfaqjes së vlerës së arkëtimit dhe arkëtimin e pagesave sipas tarifave të përcaktuara nga moduli i konfigurimit.</p> <p>Funksionet e kërkuara të kësaj ndërfaqe :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëshimin e biletave të aksesit ditore/afatshkurtra - Lëshimin e biletave të parkimit me kohe (pas pagese ose para pagese) - Lëshimi i kartave Rfid/Tag për kontratat afatgjata - Procesim të transaksionit monetar (arkëtimi) - Anulim të transaksionit - Kryerja e pagesave hyrëse dhe dalëse të arkës - Modifikimi i diferencave të pagesave cash - Mbyllja e hapja e turneve ku çdo operator ka përdoruesin e tij në sistem të mbrojtur me password - Kombinimi i kombinimit të pagesave me mënyra të ndryshme psh

	<p>Cash + Çek</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leximi i të dhënave të një karte Rfid apo bilete barcode. - Etj <p>Funksioni i prodhimit të biletave do të aktivizohet nëse do të jete e nevojshme në forme opsionale duke shtuar një printer biletash në sistem.</p> <p>Funksione opsionale të aktivizueshme me ane të licencave shtese në rast nevojë :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Funksioni opsional i përllogaritjes se tarifës se pagesës. - Funksioni i vlerësimit nëpërmjet të cilit, duke lexuar një kupon skonto ose nje bilete, mund të ofrohen skonto, tarifime të personalizuar etj. - Caktimi i biletave apo artikujve të tjerë të aksesit për një ngjarje (event) të caktuar, psh. Karta vizitori, bileta afatgjata, bileta eventit etj. - Riprodhimi i një bilete të te humbur duke vendosur targën e mjetit - Procesimi i pagesave me karte krediti - Lëshimi i rimbursimit tek karta e kreditit - Regjistrimi manual i një karte krediti me të dhënat e saj - Lëshimi i një e-Bilete (e-ticket) - Leximi i voucher opsionale - Gjenerimi i një biletë tjetër zëvendësuese në rast bilete të dëmtuar duke vendosur numrin e biletës <p>Ndërfaqja e software të jete e optimizuar për tu përdorur me ekranet me prekje (touch screen).</p>
Moduli i kontrollit	<p>Në këtë ndërfaqe, përdoruesi do të mund të monitoroje e kontrolloje të gjitha pajisjet e sistemit të aksesit. Çdo pajisje e sistemit të aksesit si kolonat, lexuesit, Pda (opsionale), терминаlet e operatorit, do të mund të shfaqen në këtë ndërfaqe në mënyrë të dallueshme me ikonën përfaqësuese për secilin model dhe për secilën portë apo korsi aksesit. Çdo pajisje duhet të shfaqet në kohe reale nëse ka ndonjë problem komunikimi apo problem tjetër funksional. Ikona e pajisjes, duhet të ndryshojë duke paraqitur në forme grafike gjendjen e sistemit.</p> <p>Operatori, mund të përzgjedh pajisjen dhe të ekzekutoje komanda mbi të si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komande për hapjen manuale të barrierës apo turnstile - Komande për bllokimin / aktivizimin e një porte këmbësorësh apo korsie automjetesh - Komande për reset e anti-passback

	<ul style="list-style-type: none"> - Komande e funksionit opsional të komunikimit me citofon me pajisjet e aksesit. - Verifikimi i vendeve të lira për një zonë parkimi të caktuar. - Caktimi i numërimit të makinave - Në kolonat hyrëse: e dalëse <ul style="list-style-type: none"> o Verifikimi i status o Hapje manuale e barrierës, lenie hapur e barrierës o Mbajtje e mbyllur e barrierës o Aktivizimi/çaktivizimi i pajisjeve <p>Gjithashtu kjo ndërfaqe duhet të shfaqë të dhëna log mbi ngjarjet e sistemit, mesazhet mbi gjendjen e sistemit si dhe mbi hyrje-daljet në zonat e sistemit të aksesit.</p>
Ndërfaqja e raportimit	<p>Në këtë ndërfaqe të ketë një funksion për nxjerrjen e detajuar të raporteve ditore, mujore apo periudhave të caktuara sipas nevojës. Këto raporte duhet të japin informacion mbi aksesin në sistem sipas çdo portë dhe të ketë mënyra filtrimi sipas kushteve të ndryshme.</p> <p>Software duhet të shfaqë raportet e sistemit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raportet ditore • Raportet mujore • Raportet filtruara • Raportet e turneve • Raportet e përdorimit të voucher • Raportet e biletave të kthyera • Raportet e fluksit të biletave • Raportet e fluksit të parave • Raportet e pagesave të vonuara • Raporte të personalizueshme <p>Përveç raporteve, sistemi duhet të mundësojë aktivizimin e log të detajuara me nivele të përzgjedhura për zgjidhjen e problemeve të sistemit. Loget duhet të kenë mundësi të përzgjidhen për çdo pajisje duke regjistruar çdo detaj të transaksioneve dhe komunikimit me pajisjet.</p>
Baza e të dhënave	Sistemi software duhet të ketë një bazë të dhënash të qëndrueshme të ndërtuar

	<p>mbi bazën e Rdbms e cila mund të jetë e instaluar në të njëjtin server apo në server të dedikuar.</p> <p>Sistemi DBMS duhet të funksionojë në sistemet operative Windows dhe të jete i shoqëruar me licencat përkatëse.</p>
Sistemi operativ	<p>Sistemi operativ duhet të jete i platformës Windows Server 2008/2012 64 bit në mënyrë qe të veproje si server për domain controller (Active Directory) për sistemin e parking.</p> <p>Sistemi operativ do të duhet të shoqërohet me licencat përkatëse.</p>
Funksione opsionale	<ul style="list-style-type: none"> - Programi i administrimit të parking duhet të ketë mundësi të integrohet me sistemin e leximit të targave nëpërmjet kamerave Lpr. Kamerat LPR mund të instalohen për të dhënë informacion mbi automjetin, ku përfshihet targa në forme tekst Ocr si dhe imazhi i mare nga kamera. Ky informacion do të përpunohet e do të administrohet në modulën e leximit të targave LPR. Moduli i programit të leximit të targave duhet të shoqërohet me licencën përkatëse për aktivizimin e funksionit në software. Kjo duhet të kete mundësinë e printimit të targës se lexuar nga LPR në rast se përdoret marrja e biletës në kolonë gjate leximit të targës. - Sistemi i Parking duhet të jetë plotësisht i integruar me APM (Automatic Payment Machine). Këto pajisje duhet të mbështeten plotësisht në sistem duke mundësuar transaksione të sigurta dhe në disa mënyra: cash; kartë. - Sistemi i Parking duhet të jetë plotësisht i integruar me kërkues elektrik dhe të ketë mundësinë e shtimit të opsioneve të ndryshme për mënyrën e faturimit të karikimit të makinave elektrike. Ky faturim të behet direkt në biletën e lëshuar në hyrje të parkimit apo nëpërmjet kartës RFID. - Sistemi i Parking do të duhet të ketë mundësinë e ndërfaqësimit me sisteme të tjera për të shkëmbyer informacion 2 drejtimesh, për marrjen dhe dërgimin e të dhënave (P.sh. Dërgimin e të dhënave nga nje sistem tjetër të lejeve të hyrjes në parking, apo marrjen e të dhënave të parking si të dhëna mbi aksesin, vlerën monetare, gjendjen e parking, etj).

6. Pajisje workstation për instalimin e programit, së bashku me monitor		
Përshkrim i përgjithshëm	Kompjuter për t'u përdorur për instalimin e software të sistemit te parking.	
Karakteristika teknike	Kompjuter Brand, me chipset dhe processor Intel	
Pikët min. për procesorin sipas: cpu benchmark.net Min Proc. Rating according to: cpubenchmark.net:	6000	
“RAM”:	8 GB, min. DDR3 1600 MHz	
Hard Disk “HDD Size”:	500 GB SSD	
“Media Device”:	DVD+/-RW	
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI		
Porta e komunikimit “Ports”:	Min. (6) porta USB, (1) RJ-45, (1) audio in/out, (1) mic. and headphone, (1) VGA.	
“Networking”:	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port.	
“Sound”:	Integrated Sound Card	
“Speakers”:	Internal or Built-in Monitor	
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:	Windows server 2016 Server x64	
“Keyboard”:	Standart Keyboard QWERTY	
“Mouse”:	Minimum 2 Button scroll Optical	
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz	
Monitor	<ul style="list-style-type: none"> - Dimensioni i ekranit, min 20” . - Rezolucion min 1600 x 900 - Kontrast 600:1 / 10000000:1 dinamik - Ndricimi 200 cd/m² - DisplayPort ose HDMI, ose VGA 	

7. Pajisje Kioske për instalimin e sistemit si dhe për pikën e pagesës së parkimit	
Përshkrim i përgjithshëm	Sistemi i Parking do të duhet të pajiset me me kioske ku do të qëndrojë operatori që do të merret me vjeljen e të ardhurave.
Karakteristika	Kioska duhet të jete material duralumin. Permasat e kioskes duhet të jene minimalisht 1.2m x 1.8m, të përshtatshme për të mbajtur një post pune bashke me pajisjet përkatëse. Kioska duhet të jete e pajisur me derë si edhe me dritare mjaftueshme të hapur për të trajtuar pagesat.

8. Letër parkimi, kompatibel me sistemin e parkimit	
Përshkrim i përgjithshëm	Letër printeri kompatibel me sistemin e parkimit.
Karakteristika	Materiali letër e bardhë e printueshme. Teknologjia e printimit : termike. Sipërfaqe rezistonte ndaj gërvishjeve. Të mund të printohet në të gjithë sipërfaqen. Kushtet ambientale -20 °C deri në +40 °C

9. Karta RFID	
Përshkrim i përgjithshëm	Karta aksesi RFID.
Karakteristika	Karta plastike e laminuar për përdorim jetegjate. Te duroj temperature deri nga -30°C deri me +50°C. Karte me permasa - 85.50 X 54mm ISO 14443 standart Mifare Classic Frekuenca 13.56 MHz. Karta duhet të ofroje siguri të larte, nejte si në kartat e kreditit. Kartat duhet të lejojne disa lloje lejesh të ndryshme. Kartat duhet të jene kompatibel me sistemin e instaluar te hyrjes se makinave.

10. Kamera LPR për hyrje dhe dalje	
Përshkrim i përgjithshëm	Kamera në formën e shtyllave në hyrje të parking të mjeteve motorike do shërbejë

	<p>për të kontrolluar aksesin e hyrjes në parking.</p> <p>Për automjetet të cilat kërkojnë të hyjnë në parking, kamera duhet të ketë mundësinë e regjistrimit të kohës së saktë të hyrjes në parking. Sapo të lexohet targa e automjetit dhe të regjistrohet në sistem, duhet të mundësohet hapja menjëherë e barrierës së automjeteve.</p>
Karakteristika fizike	<p>Kamera LPR duhet të jete e ndërtuar për këtë qëllim me përmasa të përshtatshme në mënyrë që të mundësojë leximin e targës së automjeteve nga një distance 2-4m. të jete e ndërtuar me material alumini, ose inox të pa ndryshkshem e të jete i lyer me boje në mënyrë që të durojë kushtet atmosferike, temperaturat e larta e të ulta, diellin, dhe lagështirën.</p> <p>Te jete e mbyllur në mënyrë hermetike sipas standardit IP43.</p> <p>Te punoje në temperaturat nga -20 °C deri +40 °C.</p>
CPU dhe ndërfaqet e komunikimit	<p>Kamerat LPR duhet të kenë karakteristikat</p> <ul style="list-style-type: none"> - Formati PNG - Dimensionet Bollard housing: 220 mm × 620 mm × 240 mm / 8.7" × 24.4" × 9.5" (w × h × d) Wallmount housing: 145 mm × 140 mm × 224 mm / 5.7" × 5.5" × 8.8" (w × h × d). - Orientimi Landscape - Rezolucioni 2304 × 1536 - Temperatura -25 °C to +55 °C (no direkt e ekspozuar në diell) - CPU: Procesor me shumë bërthama me motor OCR të integruar - OS: Linux Ubuntu - Ruajtja e të dhënave: memorie e brendshme flash; i zgjerueshëm me USB - OCR: motor i brendshëm OCR i bazuar në AI, i kalibruar për tregun lokal
Ushqimi dhe karakteristika ambientale	<p>Tensioni i ushqimit të kolonës 100-240 V, Max 5A</p> <p>Ushqimi i pajisjeve në barriere të jete me tension të ulet 12/24 V DC.</p> <p>Temperatura e punës -20 °C deri në +40 °C, Lagështia 90%. Shkalla e mbrojtjes nga faktorët ambientale IP65.</p>
Aksesorë	<p>Kamerat duhet të jenë të qëndrueshme dhe duhet të montohen në terren duke betonuar më parë një element mbajtës i cili duhet të funksionojë si bazament.</p> <p>Kamera duhet të ketë mundësi të montohet e çmontohet lehtësisht nga bazamenti.</p>

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT (PJESA E SISTEMIT TË PARKIMIT)

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia
1	Pajisje për lëshimin dhe matjen e kohës e parkimit, me ekran dhe aksesore	Set	1
2	Pajisje për kontrollin e pagesës së parkimit me display dhe aksesore	Set	1
3	Pajisje bariere për kontrollin e lëvizjes së mjeteve (te komandueshme nga sistemi i parkimit)	Set	1
4	Pajisje për leximin e biletave	Cope	1
5	Software qendror për menaxhimin e qendëruar të sistemit të parkimit	Set	1
6	Pajisje workstation për instalimin e programit, së bashku me monitor	Cope	1
7	Pajisje Kioske për instalimin e sistemit si dhe për pikën e pagesës së parkimit	Cope	1
8	Letër parkimi, kompatibël me sistemin e parkimit	Rulona	200
9	Karta RFID	Cope	20
10	Kamera LPR për hyrje dhe dalje	Cope	2
11	Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativ	Set	1
12	Mirëmbajtje vjeçare	Set	1

Afatet e lëvrimit: 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës përfshirë furnizimin dhe vendosjen në punë të sistemit. Garancia minimale e kërkuar për pajisjet dhe programet është 1 vit.

1. PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT

Titulli i Projektit	“Mikpritje dhe Histori në Divanin e Pashait”
Aplikanti (Emri i NJVV)	Bashkia Tepelenë
Vendndodhja e Projektit	“Rruga e Kalasë”
Kohëzgjatja e Projektit	12 muaj
Objektivi/at e projektit	<ul style="list-style-type: none">• Përmirësimi i aksesit për turistët në Tepelenë.• Promovimi i atraksioneve turistike të Tepelenës për të rritur numrin e vizitorëve.• Ofrimi i përvojave edukative dhe tërheqëse përmes teknologjisë.• Krijimi i një atraksioni të ri turistik në kala për tërheqjen e më shumë vizitorëve.• Rritja e ndërgjegjësimit për historinë dhe kulturën lokale.
Grupi (grupet) e synuara	Turistët vendas dhe të huaj, banorët lokalë, bizneset lokale të lidhura me turizmin.
Përfituesit përfundimtarë	Turistët: Rreth 30,000 vizitorë në vit. Banorët lokalë: Rreth 1,000 banorë të përfshirë drejtpërdrejt në aktivitete ekonomike të lidhura turizmin. Bizneset lokale: Rreth 50 biznese lokale që do të përfitojnë nga rritja e fluksit të turistëve dhe përmirësimi i ofertës turistike
	30,000 vizitorë dhe banorë
Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none">• Ndërtimi i një hapësire parkimi modern për turistët (vizitorët).• Marketingu i ofertave turistike të zonës.• Ofrimi i një interpretimi audiovizual për kalanë, Ali Pashën dhe trashëgiminë kulturore.• Rritja e vizitueshmërisë dhe vizibilitetit për turizmin në kalanë e Ali Pashës dhe në zonë.• Rritja e ndërgjegjësimit për historinë dhe kulturën lokale.

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT (2 FAQE)

Përshkrimi i projektit të propozuar:

- *Përshkrimi i kontekstit (nevoja) e përgatitjes së projektit;*

Tepelena është një qytet i vendosur në jug të Shqipërisë, me pasuri të shumta natyrore dhe kulturore, përfshirë Kalaja e Tepelenës dhe monumentet e Ali Pashës. Aktualisht, qyteti përballët me një mungesë të theksuar të produkteve turistike konkrete, muzeve aktive dhe pikave tregtare për suvenire, hartave informuese dhe hapësirës për vendqëndrim (parkim) të sigurtë. Kjo ka çuar në një numër të ulët vizitorësh dhe një stanjacion ekonomik për zonën, pasi vizitorët që vijnë kryesisht me mjete private ose autobuzë turistik nuk kanë asnjë mundësi për vendqëndrim të përshatshëm me qëllim që të vizitojnë pikat turistike dhe të degustojnë pijet apo ushqimet tradicionale. Projekti synon të adresojë këtë nevojë emergjente përmes krijimit të një hapësire moderne dhe të sigurt parkimi si dhe një stacioni info pointi turistik i quajtur "Divani i Pashait" që do të shërbejë si qendër informacioni dhe një këshillues turistik.

- *Shpjegimi i objektivave të projektit të paraqitura në Seksionin 1 "Informacion i përgjithshëm"*

ii. Përmirësimi i aksesit në informacion për turistët në Tepelenë

Krijimi i një parkimi modern dhe të sigurt për automjetet e vizitorëve dhe qendra informimi turistike që të sigurojë informacion të detajuar mbi atraksionet turistike, historinë, kulturën, kulinarinë e zonës etj., duke rritur kështu aksesin në informacion dhe përvojën turistike.

Aktivitetet: Ndërtimi dhe montimi i aseteve dhe pajisjeve teknologjike (Sheshi, aksesi/servituti, ndriçimi, sinjalistika, infopoint, sitemimi, pjesët funksionale etj.) të parkingut pranë sheshit të qytetit dhe kalasë së Ali Pashës.

iii. Promovimi i atraksioneve turistike të Tepelenës për të rritur numrin e vizitorëve

Marketingu i ofertave turistike të zonës për të rritur vizibilitetin dhe tërheqjen e turistëve përmes fushatave të marketingut dhe bashkëpunimit me operatorët lokalë turistikë.

Aktivitetet: Krijimi i fushatave të marketingut online dhe offline, bashkëpunimi me operatorët lokalë turistikë për promovimin e aktiviteteve dhe eksperiencave unike.

iv. Ofrimi i përvojave edukative dhe tërheqëse përmes teknologjisë moderne

Ofrimi i një interpretimi audiovizual për Kalanë, Ali Pashën dhe trashëgiminë kulturore dhe kulinare për të ofruar një përvojë edukative dhe tërheqëse për vizitorët.

Aktivitetet: Përgatitja e tre videove për interpretimin audiovizual, instalimi i touch screen që do blihet e gatshme, e cila do të aksesohet nga vetë përdoruesi në çdo kohë (orë).

v. Krijimi i një atraksioni të ri turistik në kala për tërheqjen e më shumë vizitorëve

Krijimi i një atraksioni të ri turistik në Tepelenë që do të ofrojë një përvojë të veçantë për vizitorët (impakti i parë me qytetin në parkingun panoramik), duke i tërhequr/nxitur ata të eksplorojnë më shumë zonën dhe të qëndrojnë më gjatë.

Aktivitetet: Rehabilitimi i hapësirës së parkimit dhe krijimi i aksesit për vizitorët, ndërtimi i qendrës së informacionit (Divanit të Pashait).

vi. **Rritja e ndërgjegjësimit për historinë dhe kulturën lokale**

Rritja e ndërgjegjësimit për historinë dhe kulturën lokale përmes aktiviteteve edukative dhe promovuese.

Aktivitetet: Organizimi i eventeve edukative dhe kulturore në qendrën e informacionit dhe në kala, krijimi i materialeve informuese dhe edukative për vizitorët.

- *Përshkruani grupet kryesore të interesit, interesin e tyre të projektit dhe konsultimet që mund të keni kryer me ta (nëse ka) si dhe se si në sajë të projektit do të përmirësohet gjendja e grupeve të synuara dhe të përfituesve përfundimtarë*

Grupet kryesore të interesit: Turistët vendas dhe të huaj, banorët lokalë, bizneset lokale të lidhura me turizmin.

Interesi i grupeve të interesit në projekt:

- **Turistët vendas dhe të huaj:** Të kenë akses për të qëndruar gjatë, të sigurojnë informacion përmes një ndalesë të vetme dhe të shijojnë një përvojë tërheqëse dhe edukative.
- **Banorët lokalë:** Përmirësimi i gjendjes ekonomike përmes rritjes së numrit të vizitorëve dhe krijimit të mundësive të reja për punësim.
- **Bizneset lokale:** Përfitimi nga rritja e fluksit të turistëve për të rritur shitjet dhe aktivitetin ekonomik.

Konsultimet e kryera: Konsultime me operatorët turistikë dhe banorët lokalë për të kuptuar nevojat dhe interesat e tyre (duke qenë se në qytetin e Tepelenë nuk ka vendparkime të përqëndruar për autobuzë furgona, autovetura, biçikleta, etj.). Këto konsultime kanë treguar një interes të madh për rritjen e numrit të vizitorëve dhe përmirësimin e ofertës turistike. Shqetësimi kryesor i adresuar në konsultime ka qenë qëndrimi i shkurtër i vizitorëve në qytet si dhe pamundësia për vendparkim të sigurtë, të lejueshëm dhe pranë kalasë.

Përmirësimi i gjendjes së grupeve të synuara dhe përfituesve përfundimtarë:

- **Rritja e numrit të vizitorëve:** Duke ofruar një hapësirë të sigurt vendqëndrimi për automjetet dhe aksesin e informacionit për tu njohur me mundësitë që ofron qyteti dhe zona.
 - **Përmirësimi i menaxhimit të ofertës turistike:** Përmes trajnimit të personelit dhe marketingut të efektshëm.
 - **Krijimi i mundësive të reja ekonomike për banorët lokalë:** Përmes rritjes së aktivitetit turistik shitjes dhe shërbimeve të tjera turistike.
- **Përshkrim i shkurtër mbi logjikën e ndërhyrjes që përbën bazën e Projektit, ku tregohen produktet, rezultatet, ndikimet e pritshme si dhe evidentimi i rreziqeve kryesore dhe supozimeve për arritjen e tyre:** Projekti synon të përmirësojë aksesin dhe përvojën turistike përmes krijimit të një hapësirë vendqëndrimi dhe informacioni si atraksion turistik. Kjo do të çojë në rritjen e numrit të vizitorëve dhe përmirësimin e menaxhimit të ofertës turistike.

Produktet dhe rezultatet e pritshme:

- **Krijimi i një vednparkimi bashkëkohor për turistët:** Rritja e sigurisë dhe shpërndarje e shpejt dhe e detajuar e informacionit turistik për vizitorët. Sigurimi i informacionit të detajuar dhe të aksesueshëm për vizitorët.
- **Marketingu i ofertave turistike të zonës:** Rritja e vizibilitetit të atraksioneve turistike të Tepelenës.
- **Ofrimi i një interpretimi audiovizual për Kalanë, Ali Pashën, Vjosën, Kampin e Tepelenës dhe trashëgiminë kulturore dhe kulinare:** Përvojë edukative dhe tërheqëse për vizitorët.
- **Krijimi i një atraksioni të ri turistik në kala:** Tërheqja e më shumë vizitorëve dhe përmirësimi i përvojës turistike.
- **Rritja e ndërgjegjësimit për historinë dhe kulturën lokale:** Edukimi dhe informimi i vizitorëve për trashëgiminë e zonës.

Ndikimi i pritshëm:

- i. Rritja e numrit të vizitorëve në Tepelenë.
 - ii. Përmirësimi i menaxhimit të ofertës turistike.
 - iii. Krijimi i mundësive të reja ekonomike për banorët lokalë.
 - iv. Valorizimi i trashëgimisë kulturore dhe historike të rajonit.
- *Faktori specifik dhe/apo rreziqe/supozime që mund të impaktojë afatin kohor të projektit.*
- i. **Vonesat në implementim:** Sfida teknike dhe logjistike mund të shkaktojnë vonesa në realizimin e projektit.
 - ii. **Sfidat teknike me instalimin e pajisjeve audiovizuale:** Përdorimi i teknologjisë moderne kërkon ekspertizë të specializuar dhe mund të hasen vështirësi teknike.
 - iii. **Marrja e lejeve të nevojshme:** Bashkëpunimi me autoritetet lokale për të marrë lejet e ndërtimit mund të kërkojë kohë dhe përpjekje.

Faktorët që Mund të Ndikojnë Afatin Kohor të Projektit

- i. **Marrja e lejeve të ndërtimit:** Procesi i marrjes së lejeve mund të zgjasë më shumë se sa parashikohet.
- ii. **Furnizimi i pajisjeve audiovizuale dhe prodhimi i materialeve audiovizive:** Sigurimi dhe instalimi i pajisjeve mund të hasen me vonesa logjistike.
- iii. **Trajnimi i personelit:** Trajnimi i personelit për menaxhimin e vendparkimit, qendrës së informacionit dhe pajisjeve audiovizuale mund të kërkojë kohë shtesë.

3. RËNDËSIA E PROJEKTIT (1 FAQE)

3.1. Lidhja me nevojat specifike dhe vështirësitë e rajonit të synuar (përfshirë këtu edhe sinergjinë me nisma të tjera zhvillimi dhe shmangien e duplikimeve/mbivendosjeve)

Shpjegimi i situatës specifike para projektit në rajonin dhe/ose sektorët e synuar (ku të përfshini edhe analiza me të dhëna sasiore, nëse është e mundur).

Analiza e hollësishme të problemeve të rajonit të synuar që do të trajtohen nga projekti dhe si ndërlidhen ato në të gjitha nivelet.

Situata specifike para projektit: Tepelena është një qytet me pasuri të shumta natyrore dhe kulturore, por përballet me disa sfida të rëndësishme:

- **Mungesa e hapësirave për vendparkim të përqendruar dhe informacioni turistik:** Tepelena ka shumë monumente dhe vende historike, por mungesa e vendparkimit të përqendruar në qytet dhe informacionit turistik të përqendruar, ka bërë që vizitorët të jenë të paktë dhe përvoja e tyre të jetë e kufizuar.
- **Mungesa e aktivitetit ekonomik që lidhet me turizmin:** Në një kohë kur Shqipëria po përjeton një bum turistik, Tepelena ende përballet me një mungesë të aktivitetit ekonomik të lidhur me turizmin, gjë që kufizon mundësitë për punësim dhe zhvillim për banorët lokalë.

Analiza e hollësishme e problemeve të rajonit:

- **Numri i ulët i turistëve:** Aktualisht, Tepelena tërheq rreth 30,000 turistë në vit, një shifër e ulët krahasuar me potencialin e saj. Pjesa më e madhe e turistëve vijne për hiking dhe natyrë dhe nuk qëndrojnë në qytet. Mungesa e infrastrukturës turistike kontribuon në këtë problem.
 - **Mundësitë e kufizuara ekonomike:** Mungesa e aktiviteteve turistike dhe tregtare ka kufizuar mundësitë ekonomike për banorët lokalë. Ekziston një potencial i madh për rritje në këtë sektor, i cili mund të ndihmojë në përmirësimin e kushteve ekonomike të banorëve.
 - **Trashëgimia kulturore e papërfshirë:** Monumentet dhe vendet historike, si Kalaja e Tepelenës dhe monumentet e Ali Pashës, janë të papromovuara dhe të paaksesueshme për turistët, duke kufizuar potencialin e tyre për tërheqjen e vizitorëve.
- **Referimi i çdo plani të rëndësishëm të ndërmarrë në nivel kombëtar, rajonal dhe/ose vendor që lidhet me projektin dhe përshkruani si do të ndërlidhet projekti me këto plane:**

Strategjia Kombëtare për Turizmin 2019÷2023: Projekti përputhet me objektivat e kësaj strategjie, që përfshijnë promovimin e turizmit kulturor dhe historik, zhvillimin e produkteve të reja turistike dhe përmirësimin e infrastrukturës turistike. <https://turizmi.gov.al/ep-content/uploads/2019/06/Strategjia-Komb%C3%ABtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>

Plani Operacional i Zhvillimit Vendor të Bashkisë Tepelenë: Sipas këtij plani, prioritete të rëndësishme përfshijnë zhvillimin e infrastrukturës turistike dhe promovimin e atraksioneve kulturore dhe historike për të rritur numrin e turistëve. Projekti ynë është në përputhje me këto prioritete, duke synuar të përmirësojë aksesin në informacion turistik dhe të krijojë një atraksion të ri turistik në kala. <https://tepelena.gov.al/plani-operacional-i-zhvillimit-lokal-tepelene/>

- **Projekti është vazhdim i një projekti të mëparshëm apo që plotëson një projekt në vazhdim, tregoni qartë se si projekti i propozuar do të kontribuojë/ plotësojë aktivitetet/rezultatet e projektit të mëparshëm apo në vazhdim; referojuni përfundimeve kryesore dhe rekomandimeve të çdo vlerësimi të kryer.**

Ky projekt është një vazhdimësi e projekteve të mëparshme si "Rehabilitimi i Sheshit Kryesor dhe Rrugës Ali Pasha përgjatë mureve të kalasë", realizuar nëpërmjet Programit të Rilindjes Urbane financuar nga qeveria shqiptare, si dhe projektit "Rijetëzimi i zonës historike, Kalaja e Ali Pashë Tepelenës", "Faza 1 e realizuar dhe Faza 2" në zbatim nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Ky projekt do të kontribuojë në përmbushjen e këtyre rekomandimeve duke krijuar një vendpaskim tepër të nevojshëm dhe qendër informacioni.

- **Projekti është pjesë e një programi më të madh, shpjegimi se si përputhet apo si bashkërendohet projekti me këtë program apo me projekte të tjera të planifikuara.**

3.2. Elementë të veçantë që i shtojnë vlerë projektit

Evidentimi i çdo elementi të veçantë që i shtojnë vlerë projektit (p.sh. novacione, ekologjike, smart, praktikat më të mira, etj.)

- Inovacionet teknologjike:** Instalimi i ekraneve digjitale, pajisjeve smart etj., është një element inovativ që ofron një përvojë unike dhe tërheqëse për vizitorët. Ky sistem do të sjellë një dimension të ri në përvojën turistike, duke ofruar interpretim audiovizual të historisë dhe kulturës lokale.
- Qasja ekologjike:** Projekti do të përdorë materiale të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin për ndërtimin e parkimit dhe mobilimin e qendrës së informacionit, duke minimizuar ndikimin mjedisor.
- Praktikat më të mira:** Projekti do të adoptojë praktikat më të mira të menaxhimit të qendrave turistike dhe informacionit, duke trajnuar personelin në standardet ndërkombëtare të shërbimit ndaj klientit dhe menaxhimit të informacionit.

3.3. Përfitimet dhe ndikimi që mund të sjellë projekti

- **Informacioni për ndikimin rajonal dhe përfitimet që mund të sjellë projekti për rajonin, si dhe potencialin e tij për zhvillim të mëtejshëm.**

Rritja e numrit të turistëve: Pritet që numri i turistëve të rritet me 50% në vitin e parë pas përfundimit të projektit, duke arritur rreth 30,000 turistë në vit.

Gjenerimi i të ardhurave: Me rritjen e numrit të turistëve, pritet që të ardhurat nga turizmi të rriten ndjeshëm, duke kontribuar në ekonominë lokale dhe duke krijuar mundësi të reja për bizneset lokale.

Punësimi: Projekti do të krijojë mundësi të reja punësimi për banorët lokalë, duke përfshirë punësimin e stafit për qendrën e informacionit dhe parkimit.

Promovimi i trashëgimisë kulturore: Projekti do të ndihmojë në promovimin dhe valorizimin e trashëgimisë kulturore dhe historike të Tepelenës, duke e bërë atë një destinacion tërheqës për turistët dhe studiuesit.

Zhvillimi i mëtejshëm: Projekti ka potencialin për të nxitur zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës turistike në rajon, duke inkurajuar investime të reja dhe projekte të ngjashme në të ardhmen.

4. PLANI I AKTIVITETEVE

4.1. Listimi i aktiviteteve të parashikuara të projektit ku të përshkruhet shkurtimisht secili aktivitetet, kohëzgjatja e parashikuar dhe rezultatet e pritshme të tyre.

Lista e aktiviteteve të parashikuara:

- Përgatitja e funksionalitetit, plani i biznesit, plani i promovimit, realizimi i 1 eventi, Publikimi në Faqen zyrtare të Bashkisë dhe Rrjetet sociale, Përgatitja e materialeve dhe strategjive për promovimin turistik.
- Detyra e projektimit, Projekti dhe Relacioni Teknik (Projekt ideja dhe projekti i zbatimit).
- Pajisja me lejet infrastrukturore përkatëse (kohëzgjatja 1 muaj).
- Ndërtimi i vendparkimit, pjesëve funksionale dhe Info Point-it.
- Furnizim-Vendosje e sistemeve smart dhe sinjalistikës.
- Mbikëqyrja e investimit/punimeve.
- Kolaudimi i investimit/punimeve dhe marrja në dorëzim nga NJVV.
- Përgatitja e tre videove për interpretimin audiovizual, Krijimi dhe prodhimi i videove për kalanë, Ali Pashën dhe trashëgiminë kulturore dhe kulinare.

4.2. Plani i prokurimit të projektit

Objekti i prokurimit	Shuma maksimale e parashikuar (Lekë)	Burimet e financimit (Autoriteti Kontraktues, NJVV, burime të tjera)	Lloji i procedurës së prokurimit	Koha e parashikuar për realizimin e procedurës
Përgatitja e funksionalitetit, plani i biznesit, plani i promovimit, realizimi i 1 eventi, Publikimi në Faqen zyrtare të Bashkisë dhe Rrjetet sociale, Përgatitja e materialeve dhe strategjive për promovimin turistik	-	Autoriteti Kontraktues	E hapur, Punë	4 muaj
Projekti dhe Relacioni Teknik	-	Autoriteti Kontraktues	E hapur, Punë	2 muaj
Ndërtimi i vendparkimit, pjesëve funksionale dhe Info Point-it	-	Autoriteti Kontraktues	E hapur, Punë	8 muaj
Furnizim-Vendosje e sistemeve smart dhe	-		E hapur, Punë	2 muaj

sinjalistikës		Autoriteti Kontraktues		
Mbikëqyrja e investimit/punimeve	-	Autoriteti Kontraktues	E hapur, Punë	8 muaj
Kolaudimi i investimit/punimeve dhe marrja në dorëzim	-	Autoriteti Kontraktues	E hapur, Punë	1 Javë
Përgatitja e tre videove për interpretimin audiovizual, Krijimi dhe prodhimi i videove për kalanë Ali Pashën dhe trashëgiminë kulturore dhe kulinare	-	Autoriteti Kontraktues	E hapur, Punë	4 muaj

5. NDIKIMI DHE QËNDRUESHMËRIA E PROJEKTIT (1 FAQE)

Përshkruani ndikimin që parashikohet të ketë projekti tek grupi i synuar/përfituesit e tij përfundimtarë dhe përdorni të dhëna sasiore kudo që është e mundur. Shpjegoni se si pritet që rezultatet/produktet kryesorë të projektit të japin një kontribut të rëndësishëm dhe afatgjatë për zgjidhjen e sfidave të synuara.

Shpjegimi se si projekti do të jetë i qëndrueshëm pas përfundimit të tij:

- Qëndrueshmëria financiare: p.sh., financimi i aktiviteteve vijuese më vonë, burimet e të ardhurave për të mbuluar të gjitha kostot e ardhshme operative dhe të mirëmbajtjes;
- Qëndrueshmëria institucionale: p.sh., strukturat që do të mundësojnë që rezultatet e projektit të vazhdojnë të jenë funksionale edhe pas përfundimit të projektit, ngritja e kapaciteteve, marrëveshjet dhe “pronësia” vendore e rezultateve të projektit.
- Qëndrueshmëria mjedisore (nëse ka): Çfarë ndikimi do të ketë ky projekt në mjedis? Ky informacion duhet të paraqitet vetëm për ndërhyrje që mund të kenë ndikim të rëndësishëm në mjedis.

Ndikimi që parashikohet të ketë projekti tek grupi i synuar/përfituesit përfundimtarë: Projekti pritet të rrisë ndjeshëm numrin e vizitorëve në Tepelenë, të përmirësojë menaxhimin e ofertës turistike, dhe të krijojë mundësi të reja ekonomike për banorët lokalë. Duke ofruar një përvojë unike dhe immersive për vizitorët, projekti do të ndihmojë në valorizimin e trashëgimisë kulturore dhe historike të rajonit. Pritet që rezultatet kryesore të projektit të japin një kontribut të rëndësishëm dhe afatgjatë për zgjidhjen e sfidave të synuara.

Qëndrueshmëria e projektit pas përfundimit të tij

- Qëndrueshmëria financiare:** Financimi i aktiviteteve vijuese do të sigurohet përmes të ardhurave nga biletat, shitjes së suvenireve dhe shërbimeve të tjera turistike. Bashkia Tepelenë do të krijojë një agjenci/shpk për operimin e info point-it, e cila do të sigurojë qëndrueshmërinë financiare të projektit.
- Qëndrueshmëria institucionale:** Strukturat që do të mundësojnë që rezultatet e projektit të vazhdojnë të jenë funksionale përfshijnë ngritjen e kapaciteteve të stafit dhe bashkëpunimin e ngushtë me operatorët turistikë lokalë. Marrëveshjet dhe “pronësia” vendore e rezultateve të projektit do të sigurojnë vazhdimësinë e tyre.

- **Qëndrueshmëria mjedisore:** Projekti do të ketë një ndikim pozitiv në mjedis përmes promovimit të turizmit të qëndrueshëm dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore të rajonit. Nuk priten ndikime negative të rëndësishme në mjedis.

6. BUXHETI

Informacioni mbi buxhetin e projektit	
Shuma e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues (në Lekë)	19,500,000 Lekë
Shuma e bashkëfinancimit nga NJVV/burime të tjera financimi (në Lekë)	1,300,000 Lekë
Shuma Totale e Projektit (në Lekë)	20,800,000 Lekë

Buxheti për projektin e propozuar

Titulli i Projektit: Mikpritje në Divanin e Pashait

Kosto	E gjithë periudha							
	Njësia matëse	Sasia	Kosto/njësi	Kosto totale neto	TVSH	Totali	Financimi SNKB	Bashkë-financimi Aplikantit
1	2	3	4	5	6	7 (5+6)	9	10
1.Punë								
Ngritja dhe mobilimi info-point dhe rehabilitimi i hapësirës pranë murit të kullës juglindore	cope	1.0						
Punë Total								
2. Pajisje/Mallra								
Instalimi i dhomes dhe sistemit të projektimit	cope	1						
Përgatitja dhe blerja e suvenireve për dyqanin	cope	1						
Pajisje Total								
3. Shërbime								
Supervizion								
Kolaudim		1						
Përgatitja e konceptit turistik, plani i promovimit evente promovuese dhe social media(ekspertize)	cope	1						
Përgatitja e tre videoeve për interpretimin audiovizual	cope	3						
Kosto te operimit per nje vit (operator sherbimi)	cope	2						
Projektim	cope	1						
Shërbime Total			6,465,000	6,700,000	1,775,000	7,773,500	7,624,000	149,500
Total			19,465,000	20,700,000	4,375,000	16,200,000	23,224,000	149,500

7. AUTORITETI KONTRAKTOR

Informacioni për të kontaktuar aplikantin në lidhje me këtë projekt	
Adresa postare e Aplikantit:	“Sheshi Lord Bajron”.
Adresa email e Aplikantit :	info@tepelena.gov.al
Personi i kontaktit për këtë Projekt:	Aleksandër Toti
Email i personit të kontaktit:	aleksander.toti@tepelena.gov.al
Nr. Telefoni:	+355684363334

**PËR DPKZHT
INXH. LORENC BAMI**